

ERSID KARAJ
PENGJET E KUJTESËS
POEZI

BOTIMET TOENA

ERSID KARAJ

PENGJET E KUJTESËS

poezi

BOTIMET TOENA

Tiranë

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Edona Marku Huqi

Korrektore letrare: Majlinda Toçi

Përkuqdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 9789928376954

© Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al>

Parafjalë

Rreth librit “Pengjet e kujtesës”, nga Ersid Karaj

As sot e kësaj dite nuk jam takuar personalisht me poetin Ersid Karaj. Herën e parë që rashë në kontakt me poezitë e tij në dorëshkrim, ishte në fillim të vitit 2019, kur Ersidi ishte ende nxënës në shkollën e mesme. Profesori i tij, bashkëstudenti dhe miku im prej më shumë se dyzet e pesë vjetësh, Adriatik Petrela, më kishte nisur një cikël me poezi të Ersidit, për t'i ofruar nxënësit të vet, një mendim sa më profesional për rrugëtimin e mëtejshëm poetik. Gjithmonë më ka pëlqyer dhe e kam bërë me qejf njohjen dhe ndihmën për rishtarët dhe punëtorët e rinj të letrave, qysh nga koha që punoja si redaktor te gazeta “Zëri i rinisë”. Në përmbyllje të letrës që i nisa Adriatikut, mbasi i lexova poezitë e Ersidit, mes të tjerash, i shkruaja: “Ersidi është një rast që duhet përgëzuar dhe që nëse do të punojë, nuk do ta ketë vështirë të afirmohet.”. Dhe vërtet brenda atij viti, Ersidi publikoi librin e tij

të parë me poezi me titullin “As në qiell, as në tokë”, që u prit mjaft mirë nga publiku.

Libri i ri “Pengjet e kujtesës”, që Ersidi po i paraqet lexuesit, është pa dyshim një stad i ri në krijimtarinë e tij. Në vargjet e këtij libri, ka më shumë shqetësim e dashuri, më shumë sinqeritet e dhimbje, më shumë qëndresë e brishtësi, më shumë fëmijëri dhe burrërim e si rrjedhojë, më shumë figuracion e ndjeshmëri artistike. “Ti hyre në jetën time si ëndërr në mesnatë,/ Mes prekjeve të buta, mes dheleve të ngrohta./ Godite në zemrën time me shpatë të zjarrtë,/ Imazhet e turbullta dhe fjalët e ftohta./ Tani pres të zgjohem nga ëndrrat e mesnatës,/ Dhe të të gjej në brendësinë e fjalës.” Kjo është poezia “Ti”, që vetëm me gjashtë vargje, rreth dyzet fjalë, si një prizëm gjashtëfaqësh, i cili na tregon lëvizjen, ëndërrimin, kënaqësinë, përkujdesjen, goditjen e vetvetishme të dashurisë, hutimin dhe shkrirjen e akujve të fjalëve, pritjen për të bindur veten dhe botën dhe për t’ia dhuruar lexuesit gjithë këtë vorbull përjetimesh, të kondensuar në brendësinë e fjalës poetike. Një rrëfim, një metaforë e plotë, njëqind ngasje e përjetime, që e shoqërojnë për shumë kohë lexuesin e vëmendshëm.

Kur poezia është e realizuar mirë, kur ajo krijon një “trup”, një njësi, një univers, që lind dhe vdes sipas ligjeve të veta, një organizëm të gjallë që frymon, regëtin, mbijeton e shuhet për t’u rilindur sërish, për të nuk mjafton as një libër i tërë, që ta zbërthesh, shpjegosh e analizosh. Ka shumë të thëna

e teori për artin e krijimit. Përgjithësisht, ato përpiqen ta shpjegojnë artin, ashtu si shpjegojnë shkencën. Ato na kanë ngulitur në mendje, se nga një pikë jashtë një drejtëze, mund të hiqet një dhe vetëm një vijë paralele, me drejtëzën ekzistuese. Në pikturë, në muzikë, e ca më shumë në poezi, mund të hiqen dy, tri, treqind e më shumë “paralele”. Sa më i madh të jetë numri i “paraleleve”, aq më e madhe është fushëpamja e shfaqjeve dhe e përjetimeve që merr dhe jep lexuesi, i cili përcakton edhe jetëgjatësinë e krijimit. Poezia “Ti”, të cilën e mora si shembull më lart, është një krijim që për mua heq shumë paralele.

Një koncept tjetër, që dua ta cek në këtë parafjalë, është edhe mënyra e plotësimit të pazëllit poetik, nga vetë poeti. Ndryshe nga shkenca, muzika, proza etj., poeti plotëson me të gjitha botimet dhe librat e vet një pazëll, i cili përbën “Librin” e jetës së tij. Pa dashur të merrem me stilin shumë të zhvilluar në diskutimet tona, ku për çdo botim e autor flitet për kryeveprën, për librin që po lexoj mund të them vetëm kaq: Ersidi, me këtë botim të ri, është në rrugën e suksesshme dhe të vështirë të ndërtimit të pazëllit të tij poetik.

“Pengjet e kujtesës” që lexuesi po merr në dorë, nuk është një produkt inxhinierik, nuk është një formulë apo një algoritëm. Libri është një produkt i gjallë që vjen nga jeta, përvoja dhe leximet e Ersidit. Siç e thotë edhe vetë, ai nuk është një “bimë” e selitur në kushte ideale, por është një shpërthim i vetvetishëm i qenies që di të rezistojë e të mbijetojë e shëndetshme. “Unë

jam një peng në vetminë e kujtesës,/ Si zog pa strehë
fluturoj mes qiejve./ Me sytë e verbuar dhe krahët
lidhur,/ Kërkoj njeriun e fshehur mes engjëjve.”
(Poezia “Pengjet e kujtesës”).) Por e ka vështirë ta
gjejë Njeriun, sepse njeriu e ka shitur lirinë e vet,
“Lirinë e shitëm./ Si zogj shtegtarë nëpër botë ikëm,/
Me zemër të ngurtësuar e njëkohësisht të vrarë./ E
shitëm... e shitëm.” (Poezia “Liria”).) Por edhe kur
nuk e kemi shitur vetë, duke mos na llogaritur kush si
aksionerë, të tjerë e shesin lirinë dhe të ardhmen tonë.
“Ja, e nesërmja erdhi, por nuk është prapë imja,/ E
njëjtë si e djeshmja, rri diku brenda meje./ Me vrapin
e hedhur mbi lëkurën intime,/ Kërkoj me ngut veten
brenda teje./ Nuk e duroj dot veten të larguar nga
vetja...” (Poezia “Jeta ime nuk është më imja”).)

Përpos dhimbjes që përbën thelbin e librit, e cila
duket se është e brendshme, jo e shtirë dhe artificiale,
e rritur me autorin bashkë me fëmijën e trishtë, në
poezinë e Ersidit ka një zhgënjim e humbim, që
bëhet lokomotiva e zbulimit të pjesës së brishtë, të
dridhshme e të ndritshme të jetës, që di të mbijetojë
edhe në mes të vështirësive. Në poezi, përgjithësisht
trishtimi lind farë poetike dhe përsiatje filozofike e
njerëzore jetëgjata. Pikërisht deziluzioni, mungesa,
humbja e njeriut të dashur, e bëjnë poezinë e tij edhe
më humane, më me dritë. “E kam ditur ikjen tënde,/
Kur dorën time hiqje enkas nga supet, bashkë me
gjethet”, ose “Po unë çfarë të bëj kur bie mbrëmja,/
Kur yjet më shfaqen të bukur si ti?”, e më tej “Më

duket sikur ke shekuj,/ Që të mbaj të fshehur nën
lëkurë”/ “Brenda meje dëgjohen/ zhurmat...”.

Për të mbyllur këto radhë të këtyre shënimeve, që ndoshta nuk do të mbyllen dot këtu, së fundi, dua ta përgëzoj autorin për sistemin e tij të referencave nga përpiqet të mësojë artin e vështirë të vjershërimit. Ai ka një orientim të qartë që të lexojë si mentorë poetët më të mirë të letërsisë shqipe. Por duhet ta zgjerojë e thellojë më tej rrethin e tyre, e në mënyrë të veçantë, të zgjerojë e thellojë kërkimin e njohjen e poetëve dhe poezisë së madhe botërore.

ILIRIAN ZHUPA
Bari, Itali, 23.09.2023

VENDIT TIM

Ndonëse shpeshherë kam ikur larg teje,
Ndonëse shpeshherë më ke përzënë.
Prapë kam ardhur ashtu i turpëruar
Dhe asnjë fjalë nuk të kam thënë.

Më vijnë ndër mend kujtimet,
Ndërsa ti me gishta nis dhe m'i tregon.
Sa herë vij e largohem larg teje,
Marr me vete pengjet si gjithmonë.

Po unë t'i kam falur gabimet,
T'i kam falur kur jam pranë dhe kur jam larg,
Në mijëra zemërata e keqtrajtime,
T'i kam falur të gjitha, o vendi im i ngratë!

LIRIA

Lirinë e shitëm.

Si zogj shtegtarë nëpër botë ikëm,
Me zemër të ngurtësuar e njëkohësisht të vrrarë,
E shitëm... e shitëm.

Lirinë e shesim përditë,

Ua dhurojmë në duar sendeve.
Harrojmë familjen, harrojmë vendlindjen,
Ua dhurojmë planetëve.

Lirinë e vdesim,

Ua dhurojmë dashurive të pamërituara,
Shpresës që vdes brenda nesh kur mbylлим sytë,
Ëndrrave të përealizuara.

Lirinë e dhurojmë,
Sikur të mos mjaftonte si e tillë nën lëkurën tonë.
E prekim, e shkatërrojmë,
Dhe kujtohemi për të tepër vonë.

PENGJET E KUJTESËS

Unë jam një peng në vetminë e kujtesës,
Mbështetur pas dashurisë në klithma e në heshtje.
Mes pyllit të dendur dhe dimrit të lagësht,
Kam udhëtuar pas ëndrrave ballë çdo pengese.

Unë jam një peng në vetminë e kujtesës,
Si zog pa strehë fluturoj mes qiejve.
Me sytë e verbuar dhe krahët lidhur,
Kërkoj njeriun e fshehur mes engjëjve.

BOTË E PANDERSHME

Ajri puthet me botën,
Dielli puthet me tokën,
Hëna puthet me natën,
Yjet puthen me hapësirën.

Retë puthen me qiellin,
Drita puthet me errësirën,
Fjala puthet me shpirtin,
Urrejtja puthet me dëshirën.

Uji puthet me avullin,
Zjarri puthet me hirin,
E mira puthet me të ligën,
Njeriu puthet me natyrën.

Nga kjo botë nuk shoh diçka të ndershme,
Secila godet dhe puth në mënyrën e vet.
Kur e dimë që jeta nuk është e përjetshme,
Atëherë, pse “nderi” është kaq i shenjtë?!

PËR DIKU LARG DO TË NISEM

Mora xhaketën time dhe i brengosur u nisa,
As vetë nuk dija se nga do të shkoja.
Doja në vetvete të ikja, të arratisesha
Dhe kokën mbrapa kurrë të mos e ktheja!

Në ndonjë vend ku s'ka zëra dhe ku s'ka njerëz,
Për diku larg ku s'ka frymë ironie;
Atje ku s'më ndjekin hijet e zeza tinëz,
Atje ku sytë më nuk shohin shenja tradhtie...

Ndoshta, në ndonjë vend të bukur të Shqipërisë,
Ku ajri është i pastër dhe të dhuron gjallëri.
Ndoshta dhe veten do ta fus në kuti të hermetikës,
Ku mbase dhe errësira do të më mbysë si njeri.